

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 16.09.2021

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Ulje e pagës deri në 40%, deri në 1 vit” ndaj gjyqtarit H.S.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar hetimin disiplinor ndaj magjistratit H.S. me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazuar në praktikën e nisur ndaj magjistratit në vitin 2017 nga Inspektoriati i KLD-së dhe e përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Background: Më 25.04.2017 Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nisi hetimin disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, H.S., për shkelje të përsëritur të dispozitave urdhëruese procedurale civile dhe shkelje solemniteti gjatë dhënies së vendime gjyqësore me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi, mbi bazën e ankesave të paraqitura pranë tij nga personi juridik Shoqëria “N.O.A” sh.a. dhe më vonë nga BKT. Më 26.03.2018, Inspektoriati i KLD vendos bashkimin e procedimeve hetimore ndaj gjyqtarit me objekt mosrespektimin formal të ligjit dhe harton raportin hetimor. Më 12.06.2018 Këshilli i Lartë i Drejtësisë i përcjell Ministrit të Drejtësisë relacionin ku evidentohen shkelje të pajustificuara e të përsëritura nga gjyqtari të dispozitave urdhëruese procedurale civile në 9 raste, të konstatuara në gjykimin e kërkesave për lëshim urdhër ekzekutimi, për të vlerësuar mundësinë eventuale mbi fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë z. Hektor Sinanaj. Kompetencë kjo, e cila nuk është ushtruar nga ana e Ministrit të Drejtësisë.

Dosja është përcjellë nga KLGJ pranë ILD më 06.04.2021 dhe më 15.06.2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur vazhdimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit H.S., duke administruar dokumente shitesë, pasi nga organi kompetent ishin hetuar pjesërisht (për shkak të kompetencave të kufizuara dhe të ndara ndërmjet organeve të ndryshme gjatë periudhës tranzitore), një sërë rrethanash, të cilat kanë të bëjnë me veprimet apo mosveprimet e magjistratit, të konsideruara shkelje disiplinore.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, provohet se:

- Magjistrati, në mënyrë të përsëritur ka zbatuar gabimisht legjislacionin procedural dhe material, shkelje të konstatuara edhe nga gjykata më e lartë.
- Shkeljet kanë të bëjnë me mosrespektimin e rëndë të normave të detyrueshme procedurale civile dhe janë evidentuar në të paktën gjashtë vendime objekt hetimi. Pavarësisht konstatimeve të gjykatës më të lartë, e njëjta shkelje është përsëritur edhe gjatë viteve 2020–2021, duke marrë karakter të vazhdueshëm.
- Shkeljet vlerësohen si të kryera me dashje direkte, pasi magjistrati ka mbajtur në mënyrë të vazhdueshme të njëjtin qëndrim, duke refuzuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për aktet e dhënies së kredive bankare ose nga institucionet financiare jobankare, kur këto nuk ishin akte noteriale.
- Përvoja prej 21 vitesh si gjyqtar nënkupton njohuri të konsoliduara mbi ligjin dhe veçanërisht mbi dispozitat procedurale urdhëruese. Megjithatë, magjistrati i ka shkelur ato

në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme, duke krijuar perceptimin e një trajtimi të njëanshëm në dëm të palës kërkuese.

- Si pasojë, veprimet e tij kanë ndikuar në dhënien e drejtësisë, kanë cenuar prestigjin e gjyqtarit dhe besimin e publikut te drejtësia.

Për sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit H.S. për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe pranimin e propozimit për masë disiplinore *“Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të gjatë se një vit”*, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja “i” dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;